REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E OBILIQIT OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Dalës-Izlazna
Nr.-Br. -1-121 Data-Datum 30.09.2020
OBILIQ-OBILIĆ

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosova**
**Qeveria - Vlada - Government**
**Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obilić - Municipality Assembly Obiliq**

Në mbështetje të nenit 12,14.2 ,17 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 3 pika 1.4 , neni 6 pika 1.2 , neni 8 pika 1.3 dhe neni 11 pika 3.1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 nenit 44.1 dhe 47.3 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016 dhe neni 39 i Rregullorës së Punës së Kuvendit nr.I-95,dt.29.06.2018 dhe propozimet e Kryetarit të Komunës ne II-1041,dt:23.09.2020 dhe propozim vendimi i Kryetarit të Komunës nr.II-1089 dt.25.09.2020, Kuvendi Komunës në mbledhjen e mbajture më datë 29.09.2020 mori këtë:

# VENDIM
# PËRFUNDIMTAR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË OBILIQIT NË ZONËN KADASTRALE NË LLAZAREVË

**I**

Miratohet Vendim për dhënien e pronës së paluajshme të Komunës , në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit N.SH '' A.M.C '' me adresë :Prishtinë ,Lagjja Dardani ,Nr 1/5,1/6,1/7 zona I

**II**

Sipas pikes **I** të këtij vendimi :

**1.** N.SH '' A.M.C '' është shfrytëzues i pronave të paluajtshme të Komunës

**2.** Pronat e Komunës gjenden në zonën kadastrale Llazarevë Njësia Kadastrale si në vijim P-72614041-00124-17 , me sipërfaqe të përgjithshme prej 17262 m², Vend i quajtur "Harëdhia" zone-Rrurale, zk.Llazarevë sipas Planit Zhvillimor Komunal parcela është Zonë Industriale, e evidentuar në Çertifikatën e Pronës në emër të P.SH.KK OBILIQ . Sipas nenit 11 pika 3.1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092

**3** .Shrytëzimi i pronës do të jetë për 99 vjet nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi , pas përfundit te këtij afati pronat i kthehen titullarit .

**4** .Në pronën e paluajtëshme të Komunës do të ndërtohet objekti për nevoja të N.SH '' A.M.C ''



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E OBILIQIT OPŠTINA OBILIĆ REPUBLIKA

**III**

Dhënia në shrytëzim e pronave të paluajtëshme të cekur në pikën II , bëhet me kompenzim

**IV**

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë , të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shryetëzuesit të pronave të paluajtshme të Komunës

**V**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtorati për Planifikim Urban,Pronë dhe Kadastër,Drejtorati për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspekcion.

**VI**

Obligohet Drejtoria e Planifikimit Uraban , Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës të regjistron në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.

**VII**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

**Kuvendi i Komunës së Obiliqit**
Nr. I-121- , më 29 Shtator 2020

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

**Burim Gërguri**

T'i dërgohet
-Kryetarit
-Kryesuesit
-MPL
-DPUKP
-DMM
-DEZHF
-DI
-Palës
-Anëtarëve të Kuvendit
-Arkivit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Dalës-Izlazno
Nr. 11-1083 Data 25-09-2020
Br. Datum
OBILIQ-OBILIĆ

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova

Qeveria - Vlada - Government

---

Komuna Obiliq - Opśtine Obilić - Municipality Obiliq

Në mbështetje të nenit 58 pika (h), neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 11 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019,nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi1.3 dhe nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016 , Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-47 dt.24.05.2016 për dhënien në shfrytzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit për ngastrat Kadastrale Nr.00124/2 dhe nr.00126/1 zk.Llazarevë të cilat pastaj janë parcializuar dhe janë krijuar parcela të reja .Pas negociatave të Kryetarit të Komunës ku të pranishëm kanë qenë Bordi i Drejtorëve si dhe Përfaqësues të Kuvendit Komunal dhe deputetët në njërën anë dhe Kompania N.SH."A.M.C" për Njësinë Kadastrale 00124-17 e cila është pjesë përbërse e Regjistrit të Pronave Komunale të cilat gjenden në web faqen e Komunës, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e radhës, të miratojë këtë :

**PROPOZIM**
**VENDIM**
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

Neni 1

Me këtë Vendim i jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite Investitorit N.SH."A.M.C" me adresë Lagja Dardani NR.1/5,1/6,1/7 zona I – Prishtinë, Njësia Kadastrale si në vijim:

P-72614041- 00124-17 me sipërfaqe të përgjithshme prej 17262m², Vend i quajtur "Harëdhia", zk.Llazarevë sipas Planit Zhvillimor Komunal parcela është Zonë Industriale, e evidentuar në Çertifikatën e Pronës në emër të P.SH.KUVENDI KOMUNAL OBILIQ .

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfytëzim të pronave komunale është zhvillimi i aktiviteteve biznesore si dhe gjenerimi i vendeve te reja te punës sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore

Neni 3

Obligohet Drejtorati për Planifikim Urban,Pronë dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatgjatë në afat prej 99 vitesh.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtorati për Planifikim Urban,Pronë dhe Kadastër,Drejtorati për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspekcion.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqe të Komunës.

**Arsyetim**

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092 , Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016.

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi1.3 dhe nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës sipas autorizimeve të veta në prani të Bordit të Drejtorëve si dhe Përfaqësues të Kuvendit Komunal dhe deputetët me datë 02.09.2020 ka negociuar me ofertuesin N.SH."A.M.C" me adresë Lagja Dardani NR.1/5,1/6,1/7 zona I – Prishtinë dhe sipas kërkesës dhe Projektit ideor dhe sipas negociatave investitori planifikon që në njësinë e lartëcekur të realizoj investim të ri respektivisht të ndërtoj krijimin e një qendre multifunksionale në të cilën veprimtaria kryesore do të jetë organizimi i koncerteve si dhe do të ketë skenë mobile për shfaqje teatrale , skenografi mobile televizive , xhirime profesionale dhe krijimtari të ndryshme kulturore , artistike , muzikore dhe edukative . Vlera Investive në total do të jetë 2 milion € . Përveq rritjes së vlerës së Pronës Komunale nga ky projekt sipas Projektit ideor do të gjenerohen edhe vende të reja të punës ku përparësi do të kenë banorët e Komunës së Obiliqit .

Andaj me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës së pronës publike komunale, krijimit të të hyrave vetanake në një anë dhe ofrimit të kushteve për krijimin e vendeve të reja të punës në anën tjetër përmes bërjes së politikave të punësimit, propozohet dhënia në shfrytëzim e pronës Komunale investitorit të lartëcekur dhe siç përcaktohet në nenin 1 të këtij propozim-Vendimi kërkojmë nga Kuvendi Komunal miratimin e këtij propozim-Vendimi.

KRYETARI I KOMUNËS

Xhafer Gashi

REPUBLIKA KOSOVA
DREJTORIA PËR ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME
ADMINISTRACIJE
Nr. II-1041 Data 23.09.2020
Br. Datum

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo- Republic of Kosova**
**Qeveria - Vlada - Guvernment**

**Komuna Obiliq - Opštine Obilić - Municipality Obiliq**

| | |
|---|---|
| **Data** | 23.09.2020 |
| **Për** | Burim Gërgurin – Kryesusi i Kuvendit Komunal - Obiliq |
| **Nga** | Xhafer Gashi – Kryetar i Komunës |
| **Lënda** | Kërkesë |

Kërkojm nga Kryesusi i Kuvendit Komunal në Obiliq që në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunës të futet në rend të ditës kërkesa për Dhënja në shfrytëzim të parcelave në zonen kadastrale në Llazarev duke u bazuar në kërkesat Kompanive .

Kësaj kërkese i bashkangjesim të gjitha kërkesat e skenuar të Kompanive dhe listen :

1. N.T.SH " Tre"
2. N.SH."A.M.C"
3. Kompania Kosore për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – SH.A.
4. N.T.SH. "DIARI"
5. Bermas Therm SH.P.K
6. Bimer Group SH.P.K
7. A-D-E Group SH.P.K

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT**
**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72614041-00124-17

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **05-2193-20** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 25.09.2020 - 15:10 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | Obiliq / Obilić / Obiliq |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | LLAZAREVË / LAZAREVO / LLAZAREVË |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | Obiliq / Obilić / Obiliq |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-72614041-00124-17** | **PARCELË / PARCELA / PARCEL** | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | **17262** | Ndarja e parceles ne bazë te kerkeses nga Komisioni Vlersues per dhënjen e pronës se paluajtëshme te Komunes (Nr.lendes 05-635/2016) studimi nga ZKK Obiliq. | 23.09.2016 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| HARËDHIA/HARËDHIA/HARËDHIA | | HARËDHIA | 23.09.2016 | |

**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja ($m^2$)<br>Površina ($m^2$)<br>Area ($m^2$) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 3/Pasnjak 3 Klase/3rd Class Pasture | 17262 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | **P.SH.KUVENDI KOMUNAL OBILIQ** | KCID2604066 | OBILIQ / OBILIĆ / OBILIQ / | | | **1/1** | Vendimi V-914/16 dt. 22.09.2016 Obiliq (Nr.lrndes 05-639/16 | 23.09.2016 |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : OBILIQ
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Llazarevë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-72614041-00124-17 | Parcelë / Parcela / Parcel | 17262 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1332

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Data/Date: 25.09.2020
Koha/ Vreme/ Time: 03:26:27
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director
Nënshkrimi/Potpis/Signature:

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE
Dalës-Izlazno
Nr-Br. 11-1101 Data Datum 28.09.2020
OBILIQ-OBILIĆ

OBILIQI - OBILIĆ

**Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova**

---

**Komuna e Obiliqit - Opŝtina Obilić - Municipality Obiliq**

**Zyra e Kryetarit të Komunës**

## OFERTA E NEGOCIUAR – N. SH. "A.M.C"

Gjatë takimeve të realizuara në mes të Investitorit N. SH. "A.M.C" me adresë Lagja Dardani NR.1/5,1/6,1/7 zona I – Prishtinë me Kryetarin e Komunës, z.Xhafer Gashi , bordit të Drejtorëve dhe asambleistëve të Kuvendit Komunal për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim P-72614041-00124-17 në zonën kadastrale në Llazarevë përmes negocimit me qëllim të investimit ashu siq e parasheh Ligji Nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullorja (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës , u negociua oferta me pika kryesore të saj si në vijim të cilat më gjerësisht janë paraparë në planin ideor për investim :

- Planifikimi i investimit dhe zgjerimit respektivisht të ndërtoj një qendër multifunksionale e cila do të shërbejë për mbajtjen e koncerteve dhe festivaleve të ndryshme .Vlera e investimeve në këtë projekt në total do të jetë 2,000,000€ ;

- Qendra do të përdoret për organizimin e festivaleve të ndryshme gjatë vitit, po ashtu do t'i lejohet edhe Komunës në organizimin e festivaleve të ndryshme si dhe ofrimin e paisjeve teknike;

- Përveq rritjes së vlerës së pronës komunale nga ky projekt do të gjenerohen edhe vende të reja të punës ku përparësi do të kenë banorët e Komunës së Obiliqit ;

- Objekti planifikohet të ndërtohet nga Qershori i vitit 2021 i cili planifikohet të zgjasë 3 vite

- Me realizimin e këtij projekti qysh në vitin e parë do të punësohen deri 20 persona nga Komuna e Obiliqit , ndërsa jo më vonë se 12 muaj pas fillimit të punës do të punësohen edhe 10 persona të tjerë .

**Investitori**
**N.SH. "A.M.C"**

Desfort Berisha B.
N. SH.
A.M.C.
PRISHTINË

**Kryetari i Komunës**
**Xhafer Gashi**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIQIT
OBILIQ - OBILIĆ
OPŠTINA OBILIĆ
REPUBLIKA KOSOVO

DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlazna
Nr. I -47 Data 24.05.2016
Br. Datum

OBILIQ-OBILIĆ

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës dhe nenit 11 dhe 3.9 të Rregullores së punës të Kuvendit, nenit 6 lidhur me nenin 7, pika 3, e Ligjit Nr-04/L-144, për dhënjen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluejtshme të Komunës ( "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.35/2012" ) nenit 5 lidhur me nenin 11, të Rregullores QRK, Nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluejtshme të Komunës, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.24.05.2016, mori këtë:

# VENDIM

I. Aprovohet Propozimi paraprak për dhënjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluejtshme të Komunës së Obiliqit, në zonën kadastrale Llazarevë dhe atë:
- Ngastra kadastrale nr.00124/2, në sipërfaqe prej 211369 $m^2$
- Ngastra kadastrale nr.00126/1, në sipërfaqe prej 27115 $m^2$

II. Obligohet DPUKP, dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me Komisionin për vlerësimin e pronave të paluejtshme të Komunës, ti zhvilloj procedurat e konkurimit të hapur konform dispozitave të ligjit të cekur më lartë.

III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

T'i dërgohet
-Kryetarit,
-Nënkryetarit,
-Kryesuesit,
-MAPL-së,
-DPUKP,
- Këshilltarëve,
-Arkivit,

Kryesuesi i Kuvendit komunal
Adem Preniqi

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E OBILIQIT
REPUBLIKA KOSOVA OPŠTINA OBILIĆ
OBILIQ - OBILIĆ

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Dës-Izlazni
Nr. / Br. 11-244 Data / Datum 19.04.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIČ
MUNICIPALITY OF OBILIC

---

Në mbështetje të nenit 12,14 ,17 pika c) dhe nenit 58 pika h), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 6,7 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neneve 11,12 të të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 69 pika 4 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.01-51-2010 të datës 10.03.2010, Kryetari i Komunës propozon që Kuvendi i Komunës në Mbledhjen e radhës të miratojë këtë:

**PROPOZIM**

## VENDIM

## PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË OBILIQIT NË ZONËN KADASTRALE LLAZAREVË

### Neni 1

Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh personave fizik dhe juridik paluajtshmëritë që gjenden në zonën kadastrale në Llazarevë në ngastrën kadastrale:

-Ngastra kadastrale P-72614041-00124-2 në vendin e quajtur "Harëdhia" me kulturë tokë bujqësore ,kullosë e kl.3-të me sipërfaqe prej 211369 m² e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-2467-2015 e dt.26.11.2015 ZK.Llazarevë e evidentuar si Pronë Shoqërore e Fshatit.

- Ngastra kadastrale P-72614041-00126-1 në vendin e quajtur "Harëdhia" me kulturë tokë bujqësore,kullosë e kl. 3-të me sipërfaqe prej 27115 m² e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-2467-2015 e dt.26.11.2015 ZK.Llazarevë e evidentuar si Pronë Shoqërore e Fshatit.

## Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së lartëcekur është zhvillimi i veprimtarisë industriale respektivisht ndërtimi i ndonjë fabrike prodhuese apo përpunuese sipas standardeve të përcaktuara me dispozita ligjore.

## Neni 3

Sipas nenit 1 të këtij vendimi, prona ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh nëpërmjet konkursit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK. Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

## Neni 4

Procedurën e konkursit publik e zbaton Komisioni Vlerësues në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-136 të dt.31.10.2014, si dhe Rregullores QRK. Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

## Neni 5

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës të regjistron në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.

## Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi,Kadastër dhe Pronë,Drejtoria e Inspekcionit si dhe Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit.

## Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqe të Komunës.

## Arsyetim

Baza ligjore për të miratuar këtë propozim Vendim është përcaktuar me dispozitat e neneve 12,14 , 17 pika c) dhe neni 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 6,7 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012 ,neneve 11,12 të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 69 pika 4 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.01-51-2010 të datës 10.03.2010.

Me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës ekonomike të pronës komunale si dhe ruajtjes së mjedisit Komuna e Obiliqit ka planifikuar të jep në shfrytëzim afatgjatë në periudhë prej 99 vitesh pronat e paluajtshme që gjenden në zonën kadastrale në Llazarevë.

-Ngastra kadastrale P-72614041-00124-2 në vendin e quajtur "Harëdhia" me kulturë tokë bujqësore ,kullosë e kl.3-të me sipërfaqe prej 211369 m² e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-2467-2015 e dt.26.11.2015 ZK.Llazarevë e evidentuar si Pronë Shoqërore e Fshatit.

- Ngastra kadastrale P-72614041-00126-1 në vendin e quajtur "Harëdhia" me kulturë tokë bujqësore,kullosë e kl. 3-të me sipërfaqe prej 27115 m² e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-2467-2015 e dt.26.11.2015 ZK.Llazarevë e evidentuar si Pronë Shoqërore e Fshatit,ipen në shfrytëzim në mënyrë që subjekteve të ndryshme t'u mundësohet të ofertojnë për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme të biznesit të cilat do të ndikonin në zhvillimin ekonomik të Komunës, hapjen e vendeve të reja të punës si dhe rritjen e vlerës ekonomike të pronës komunale.

KRYETARI I KOMUNËS
Xhafer Gashi

Shtojcë :

-Çertifikatë –Njësia Kadastrale

-Kopja e Planit

-Orto-foto

KËRKESË

Drejtuar: Kryetarit te Komunes së Obiliqit

Tema: Dokumentacion shtesë për parcellën në zonen industriale

Ju lutem te pranoni Planin dinamik te investimeve ne parcellen qe e kemi kerkuar per ta marr ne shfrytezim ne emer te N.SH A.M.C - Besfort Berisha B.I

Te bashkangjitura jane dy planet dinamike te investimit, plani per sallen multifunksionale dhe plani dinamik per sallen operacionale

Besfort Berisha
N.SH A.M.C

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC

## Formulari per kerkese apo ankese

**Drejtorati/Njesia**
Kryetari Komunes

**Data** 07/08/2020

Mos shkruani në këtë pjesë

**Numri i protokolit**
**02-070/05-0015175/20**

**Afati i zgjedhjes**
06/09/2020

**Vendimi**

**1.Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:**

**Emri dhe mbiemri**
Besfort Berisha

**Numri personal**
1500991301

**Adresa e vendbanimit**
Prishtinë

**E-mail Adresa**

**Numri i tel. fiks**

**Numri i tel. mobil**
044-999-444

**Vlera për pagesë:** 0.00

**2. Mënyra e pranimit**
Kërkesa

**Statusi i lëndës**
Ne proces

**3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:**

Dukumenta shtesë

4. Dokumentet e bashkangjitura:

**Nr.** **Lloji i dokumentit**

**5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi**

Unë Besfort Berisha vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkoni nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkese dhe dokumenteve të bashkangjitura

**Pranuar nga:** sala.paci

VI) Procesverbal 12.08.2020

Shqyrtimi i lëndëve të ofertave për shujën në shfrytëzim të pronës, në Zonën Industriale, në pllatön Llazarevë

* NSH „AMC" → Besfort Bassha, i kompletuar përveç qarkullimit bankar.

Procesmbajtësi/ja

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Guvernment
Komuna e Obiliqit - Skupština Obilić - Municipality Obiliq

**Takim pune me Drejtorët për kotrollimi e dokumentave të Bizeseve që ka aplikuar për marrjen e pronave Komunale në shfrytëzim.** N.SH. AMC Besfort Berisha **Datën: 12.08.2020**

| Nr | Emri | Mbiemri | Tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Abdyrrahman | Krasniqi | 045-163-800 | [signature] |
| 2 | Zaujfe | Rrahmani | 045 163 700 | [signature] |
| 3 | Arben | Berisha | 044 238 862 | [signature] |
| 4 | FITORE | HAKHAM | 045 / 163-300 | [signature] |
| 5 | Lendita | Behxeti | 045 / 163-602 | [signature] |
| 6 | BURIM | ISMAILI | 045 130 888 | [signature] |
| 7 | | | | |
| 8 | | | | |
| 9 | | | | |
| 10 | | | | |
| 11 | | | | |
| 12 | | | | |
| 13 | | | | |
| 14 | | | | |
| 15 | | | | |
| 16 | | | | |
| 17 | | | | |
| 18 | | | | |
| 19 | | | | |
| 20 | | | | |
| 21 | | | | |
| 22 | | | | |
| 23 | | | | |
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |
| 28 | | | | |
| 29 | | | | |
| 30 | | | | |
| 31 | | | | |
| 32 | | | | |
| 33 | | | | |
| 34 | | | | |
| 35 | | | | |
| 36 | | | | |
| 37 | | | | |
| 38 | | | | |
| 39 | | | | |
| 40 | | | | |
| 41 | | | | |
| 42 | | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Guvernment
Komuna e Obiliqit - Skupština Obilić - Municipality Obiliq

**akim i Kryetarit të Komunës dhe deputetëve me Bizese për dhënien e Pronave Komunale në frytëzim -Prezatimi i Investimeve, Biznesi: N.Sh. A.M.C. Datën: 02.09.2020**

| | Emri | Mbiemri | Tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | MUHAMET | MUSTAFA | 045 892 055 | |
| 2 | ARBNORA | HASUFI | 049 066 499 | |
| 3 | LABINOT | MIRENA | 045 -855-548 | |
| 4 | Fatmir | Beltreshi | 049-356-073. | |
| 5 | BESTULLAH | Myslimi | 044 116 590 | |
| 6 | Abdyrrahman | Kranniqi | 045-163-800 | |
| 7 | DRAGAN | DANČETOVIĆ | 045 688 608 | |
| 8 | Emrej | Gashi | 044 164 909 | |
| 9 | [illegible] | PALOTA | | |
| 10 | Arben | Berisha | 044 258 062 | |
| 11 | BURIM | GËRGURI | 045 103 800 | |
| 12 | ARIAN | ZHAZANI | 045 988-222 | |
| 13 | BESFORT | BERISHA | 044 999 444 | |
| 14 | | | | |
| 15 | | | | |
| 16 | | | | |
| 17 | | | | |
| 18 | | | | |
| 19 | | | | |
| 20 | | | | |
| 21 | | | | |
| 22 | | | | |
| 23 | | | | |
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |
| 28 | | | | |
| 29 | | | | |
| 30 | | | | |
| 31 | | | | |
| 32 | | | | |
| 33 | | | | |
| 34 | | | | |
| 35 | | | | |
| 36 | | | | |
| 37 | | | | |
| 38 | | | | |
| 39 | | | | |
| 40 | | | | |
| 41 | | | | |
| 42 | | | | |

1

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

| Pranuar/Primljeno: 07.08.2020 | | | |
|---|---|---|---|
| Nj.organizative Org.jedinica III | Nr. Br. | Shtojcë: Prilog: | Vlera: Vrednost: |
| 11 - | 15175 | | |

KËRKESË

Drejtuar: Kryetarit të Komunës së Obiliqit

Tema: Dokumentacion shtesë për parcellën në zonen industriale

Ju lutem të pranoni qarkullimin bankar e biznesit N.SH A.M.C / Besfort Berisha BI si dokumentacion shtese ne parcellen komunale qe e kemi kerkuar per ta marr ne shfrytezim ne emer te N.SH A.M.C - Besfort Berisha B.I

Te bashkangjitura gjeni Qarkullimin banker per vitin 2017 – 2019

Besfort Berisha
N.SH A.M.C

Besfort Berisha B.I.
N. SH.
A.M.C.
PRISHTINË

REPUBLIKA E KOSOVËS
LETËRNJOFTIM

РЕПУБЛИКА КОСОВО
ЛИЧНА КАРТА

REPUBLIC OF KOSOVO
IDENTITY CARD



Mbiemri / Презиме / Surname
BERISHA
Emri / Име / Given name
BESFORT
Datëlindja / Датум рођења / Date of birth
06.03.1986
Gjinia / Пол / Sex
M
Shtetësia / Држављанство / Nationality
KOSOVAR
Data e skadimit / Датум истека / Date of expiry
16.12.2024
Vendlindja / Место рођења / Place of birth
PODUJEVË
Nënshkrimi / Потпис / Signature

799288

Data e lëshimit / Датум издавања / Date of issue
17.12.2014
Lëshuar nga / Издат од / Issued by
MPB / MUP / MIA
Nr. Personal / Лични бр. / Personal No
1500991301
Nr. Let. / Бр. Л. К. / ID Card No.
ID0228870
Vendbanimi / Пребивалиште / Residence
PRISHTINË

IDRKSID02288700<<<<<<<<<<<<<<<
8603061M2412160RKS1500991301<5
BERISHA<<BESFORT<<<<<<<<<<<<<<

ProCredit Bank

ProCredit Bank SH.A, Zyra Qendrore – Rr. Xhorxh Bush, Nr.26, 10 000 Prishtine, Kosove

# VËRTETIM I QARKULLIMIT

Në bazë të kërkesës suaj për të përgaditur një Vërtetim të Qarkullimit në bankë dhe në bazë të të dhënave tona, për klientin BESFORT BERISHA BI, me numer te llogarisë XK051110335797000153, totali I qarkullimit për periudhen 01.01.2017 - 31.12.2019 është :

Totali I debitemeve : 2,015,960.22

Totali I kreditimeve : 2,051,889.60

Ky vërtetim i shërben të njejtit për nevojat personale dhe nuk mund të përdoret për arsye të tjera.

Singerisht,

ProCredit Bank Sh.A. 89-3 Republika e Kosovës

Mirjeta Vokshi

Zyrtar/e i/e bankës

14.08.2020 09:27:50 AM

oCredit Bank Sh.A
. Xhorxh Bush, Nr.26
000 Prishtinë
osovë

Telefoni: +383 (0) 38 / 555 777
Fax: +383 (0) 38 / 555 776
info@procredit-group.com
www.procreditbank-kos.com

Numri Unik Identifikues: 810487191
TVSH nr. i identifikimit: 330001793
Nr. fiskal: 600018429

Drejtoreshë Gjenerale
Eriola Bibolli

amc• 

Besfort Berisha B.I
N.SH A.M.C
NUI 810926701
Tel: 044999444

Projekti - Salla multifunksionale dhe administrata
Data e fillimit - Start Date 01.06.2021
Data e mbarimit - End Date 01.09.2024
Koha e ekzekutimit - Time limit 1196

maden group

# PLANI DINAMIK

| Nr: | Plani Dinamik | Fillimi i punimeve | Mbarimi i punimeve | Koha e zgjatjes ne dite |
|---|---|---|---|---|
| **FAZA I** | | **1/Jun/21** | **1/Nov/21** | **154** |
| 1 | **PUNET PREGADITORE** | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 1.2 | Germimi dhe largimi I homusit ne pjesen rruges, ne gjendje te ngjeshur. | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 1.3 | Germimi dhe largimi I dheut ne pjesen rruges dhe siperfaqes para objektit, ne gjendje te ngjeshur. | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 1.4 | Germimi dhe largimi I homusit ne pjesen ku planifikohet te ndertohet objekti, ne gjendje te ngjeshur. | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 1.5 | Germimi dhe largimi I dheut ku jane planifikuar themelet e objektit. | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 1.6 | Furnizimi dhe shtrirja e zhavoritnën themelet e vecanta dhe trajet. | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 2 | **PUNET E ARMIMIT** | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 2.1 | Themelet e vecanta | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 2.2 | Themelet shiritore dhe shtanguese | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 3 | **ELEKTRIKA** | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 3.1 | RRUFEPRITES DHE TOKEZIM | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 4 | **UJESJELLESI DHE KANALIZIMI** | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 4.1 | KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA DHE ATMOSFERIK | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 4.2 | INSTALIMET E UJESJELLESIT | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |
| 4.3 | Pusetat Kontrullues | 1/Jun/21 | 1/Nov/21 | 154 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| FAZA II | | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 1 | PUNET E BETONIMIT | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 1.1 | Themelet e vecanta | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 1.2 | Themelet shiritore dhe shtanguese | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 2 | PUNET PREGADITORE | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 2.1 | Mbushja e nevojshme e themeleve me dhe, kalkulimi ne gjendje te ngjeshur ( dhe te cilin e marrim nga gropimi). | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 2.2 | Shtrirja e zhavorit në tri shtresa ne rrugen e planifukuar dhe komplet siperfaqja para objektit | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 2.3 | Shtrirja e zhavorit nën pllaken e perdheses | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 2.4 | Shtrimi I betonit te vrazhde me treashei 5cm para betonimit te themeleve. Jane llogaritur dy fazat e betonit te vrazhde:<br>1. Betoni I vrazhde per shtrimin e hidroizolimit<br>2. Betoni I vrazhde per mbrojtjen e hidroizolimit. | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 2.5 | Shtrirja e zhavorit 32/62mm në trashësi 30cm nën pllaken e perdheses. | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 3 | HIDROIZOLIMI | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 3.1 | Punimi I hidroizolimit ne pllake te themelit me kondor 4.0mm | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 3.2 | Punimi I hidroizolimit ne mure te perimetrike te themeleve me kondor 4.0mm si dhe mbrojtesi I hidroizolimit | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 4 | ELEKTRIKA,IT | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 4.1 | KABLLOT ENERGJETIKE (furnizimi kryesor) | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 5 | UJESJELLESI DHE KANALIZIMI | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 5.1 | Punimi I rrjetit te jashtem dhe hidrantit | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 5.2 | Punimi I rrjetit te kanalizimit * vertikalet (ne perdhese | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 5.3 | Punimi I furnizimit te rrjetit te ujesjellesit | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |
| 5.4 | Mbulimi I kanalit me dheun e gërmuar, në shtresa me trashësi 20-30cm, me ngjeshen e nevojshme | 3/Mar/22 | 1/May/22 | 60 |

| | FAZA III | 5/Mar/22 | 1/Oct/22 | 211 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **PUNET E ARMIMIT** | 5/Mar/22 | 1/Jul/22 | 119 |
| 1.1 | Pllaka e perdheses | 5/Mar/22 | 1/Jul/22 | 119 |
| 1.2 | Shtyllat dhe trajet - Perdhese | 5/Mar/22 | 1/Jul/22 | 119 |
| 1.3 | Shkallet | 5/Mar/22 | 1/Jul/22 | 119 |
| 1.4 | Pllaka e katit | 5/Mar/22 | 1/Jul/22 | 119 |
| 1.5 | Pllaka Kulmit | 5/Mar/22 | 1/Jul/22 | 119 |
| 2 | **PUNET E CELIKUT** | 5/Mar/22 | 1/Jul/22 | 119 |
| 2.1 | Shtyllat Kryesore | 5/Mar/22 | 1/Jul/22 | 119 |
| 3 | **PUNET E BETONIT** | 5/Mar/22 | 1/Jul/22 | 119 |
| 3.1 | Pllaka e perdheses | 1/Aug/22 | 1/Sep/22 | 32 |
| 3.2 | Furnizimi me material dhe punimi I fer-betonit ne dyshemet e komplet fabrikes (ne te gjitha njesite punuese) | 1/Aug/22 | 1/Sep/22 | 32 |
| 3.3 | Shtyllat dhe trajet - Perdhese | 1/Aug/22 | 1/Sep/22 | 32 |
| 3.4 | Pllaka e katit | 1/Aug/22 | 1/Sep/22 | 32 |
| 3.5 | Pllaka Kulmit | 1/Aug/22 | 1/Sep/22 | 32 |
| 4 | **TERMOIZOLIMI** | 5/Sep/22 | 1/Oct/22 | 27 |
| 4.1 | Montimit I termoizolimit pergjate themelit. | 5/Sep/22 | 1/Oct/22 | 27 |
| 4.2 | Montimit I shtreses mbrojtese te termoziolimit pergjate themelit. | 5/Sep/22 | 1/Oct/22 | 27 |

| FAZA IV | | 5/Mar/23 | 6/May/23 | 63 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | PUNET E CELIKUT | 5/Mar/23 | 1/Apr/23 | 28 |
| 1.1 | Shtyllat kryesore | 5/Mar/23 | 1/Apr/23 | 28 |
| 1.2 | Trau | 5/Mar/23 | 1/Apr/23 | 28 |
| 1.3 | Brinaku | 5/Mar/23 | 1/Apr/23 | 28 |
| 1.4 | Shtng Horizontale | 5/Mar/23 | 1/Apr/23 | 28 |
| 1.5 | Shtng Diadonale | 5/Mar/23 | 1/Apr/23 | 28 |
| 1.6 | Shtyllat sekondare | 5/Mar/23 | 1/Apr/23 | 28 |
| 1.7 | Shtng ne pullaz | 5/Mar/23 | 1/Apr/23 | 28 |
| 1.8 | Pllakezat monruese te shtyllave | 5/Mar/23 | 1/Apr/23 | 28 |
| 1.9 | Pllakezat montuese te pullazit dhe shtangimeve | 5/Mar/23 | 1/Apr/23 | 28 |
| 2 | PUNET E KULMIT | 5/Apr/23 | 7/Jun/23 | 64 |
| 1.1 | Montimi I konstrukcionit nga materiali I drurit ne kulm te administrates | 5/Apr/23 | 7/Jun/23 | 64 |
| 1.2 | Montimi I kulmit nga sandwich panelet. | 5/Apr/23 | 7/Jun/23 | 64 |
| 1.3 | Punimi I shtresave ne kulm, pambuk mineral 10cm ( 42kg/m2) | 5/Apr/23 | 7/Jun/23 | 64 |
| 1.4 | Montimi I kulmarit nga llamarina e plastifikuar ne kulmit. | 5/Apr/23 | 7/Jun/23 | 64 |
| 1.5 | Montimi I ullukut horizontal nga llamarina e plastifikuar ne kulmit. | 5/Apr/23 | 7/Jun/23 | 64 |
| 1.6 | Punimi I termoizolimit te ulluqeve horizontal me sandwich panel. | 5/Apr/23 | 7/Jun/23 | 64 |
| 1.7 | Montimi I ullukut vertikal nga llamarina e plastifikuar fi - 125mm. | 5/Apr/23 | 7/Jun/23 | 64 |
| 1.8 | Montimi I pikoreve nga llamarina e plastifikuar ne dritare si dhe atike te ballkoneve | 5/Apr/23 | 7/Jun/23 | 64 |
| 3 | MURET | 5/Apr/23 | 7/Jun/23 | 64 |
| 3.1 | Punimi I mureve perimetrike | 5/Apr/23 | 7/Jun/23 | 64 |
| 3.2 | Punimi I mureve ndarese | 5/Apr/23 | 7/Jun/23 | 64 |

| FAZA V | | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | DRITARET | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 2 | IT | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 2.1 | Rrjeti ne dysheme | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 3 | ELEKTRIKA | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 3.1 | Rrjeti ne dysheme | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 4 | ALARMI | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 4.1 | Rrjeti ne dysheme | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 5 | UJESJELLESI DHE KANALIZIMI | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 5.2 | Rrjeti ne dysheme | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 6 | TERMIKA | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 5.1 | Rrjeti ne dysheme | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 7 | DYSHEME | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 7.2 | Furnizimi me material dhe punimi I shtreses se termoizlomit | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 7.3 | Furnizimi me material dhe punimi I shtreses se nivelizimit me estrih | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 8 | FASADA | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 81 | Punimi I fasades nga Sandwichpaneli nga materiali termoizolues. | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 8.2 | Punimi I fasades nga Sandwichpaneli nga materiali termoizolues . | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 8.3 | Punimi i paneleve nga materiali. | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 8.4 | Punimi I termoizolimit ne fasade. | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 10 | SUVATIMI | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 9.1 | Suvatimi të gjitha mureve të brendshme , shtyllave dhe plafoneve, sipas specifikimit në projekt, me llaq te gatshëm ne perdhese dhe kat. | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 11 | HIDROIZOLIMI | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 11.1 | Hidrozolimi I mureve | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |
| 11.2 | Hidroizolimi dyshemese | 8/Jun/23 | 1/Nov/23 | 147 |

| FAZA VI | | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | MURET | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 1.1 | GLETIM | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 1.2 | NGJYROSJE | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 2 | DYSHEMEJA | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 2.1 | Epoxi | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 3 | DYER DHE DRITARE | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 3.1 | MURE XHAMI | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 3.2 | DYERT | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 4 | ELEKTRIKA | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 4.1 | PRIZA | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 4.2 | NDRICIMI | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 5 | IT | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 5.1 | Priza | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 5.2 | Serveri | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 6 | ALARMI | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 6.1 | Senzore | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 7 | UJESJELLESI DHE KANALIZIMI | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 7.1 | Sanitarit | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 8 | MOBILE | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 8.1 | Tavolia,karrike,dollapa | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 9 | Pajisjet teknike | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 9.1 | Skenografite | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 9.2 | Pajisjet e ndricimit profesional | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 9.3 | pajisjet e zerimit dhe audio aksesoret | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 9.4 | Kamerat dhe kabllimi | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 9.5 | Led Ekranet | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |
| 9.6 | Skena e shfaqjeve | 8/Mar/24 | 1/Sep/24 | 178 |

Basfort Berisha B. I. N. SH. A.M.C. PRISHTINË

**amc•**

**Projekti - Salla operative**
**Data e fillimit - Start Date**
**Data e mbarimit - End Date**
**Koha e ekzekutimit - Time limit**

Besfort Berisha B.I
N.SH A.M.C
NUI: 810926701
Tel: 044999444
01/Sep/26
01/Sep/28
731

maden group

| Nr. | Plani Dinamik | | Fillimi I punimeve | Mbarimi I punimeve | Koha e zgjatjes ne dite |
|---|---|---|---|---|---|
| **FAZA I** | | | **1/Sep/26** | **1/Dec/26** | **92** |
| **1** | **PUNET PREGADITORE** | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| 1.2 | Germimi dhe largimi I homusit ne pjesen rruges, ne gjendje te ngjeshur. | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| 1.3 | Germimi dhe largimi I dheut ne pjesen rruges dhe siperfaqes para objektit, ne gjendje te ngjeshur. | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| 1.4 | Germimi dhe largimi I homusit ne pjesen ku planifikohet te ndertohet objekti, ne gjendje te ngjeshur. | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| 1.5 | Germimi dhe largimi I dheut ku jane planifikuar themelet e objektit. | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| 1.6 | Furnizimi dhe shtrirja e zhavoritnën themelet e vecanta dhe trajet. | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| **2** | **PUNET E ARMIMIT** | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| 2.1 | Themelet e vecanta | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| 2.2 | Themelet shiritore dhe shtanguese | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| **3** | **ELEKTRIKA** | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| 3 1 | RRUFEPRITES DHE TOKEZIM | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| **4** | **UJESJELLESI DHE KANALIZIMI** | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| 4 1 | KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA DHE ATMOSFERIK | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| 4.2 | INSTALIMET E UJESJELLESIT | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| 4.3 | Pusetat Kontrullues | | 1/Sep/26 | 30/Dec/26 | 121 |
| **FAZA II** | | | **3/Jan/27** | **1/May/27** | **119** |
| **1** | **PUNET E BETONIMIT** | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| 1.1 | Themelet e vecanta | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| 1 2 | Themelet shiritore dhe shtanguese | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| **2** | **PUNET PREGADITORE** | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| 2.1 | Mbushja e nevojshme e themeleve me dhe, kalkulimi ne gjendje te ngjeshur ( dhe te cilin e marrim nga gropimi). | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| 2 2 | Shtrirja e zhavorit në tri shtresa ne rrugen e planifukuar dhe komplet siperfaqja para objektit | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| 2 3 | Shtrirja e zhavorit nën pllaken e perdheses. | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| 2 4 | Shtrimi I betonit te vrazhde me treashei 5cm para betonimit te themeleve. Jane llogaritur dy fazat e betonit te vrazhde<br>1. Betoni I vrazhde per shtrimin e hidroizolimit<br>2. Betoni I vrazhde per mbrojtjen e hidroizolimit. | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| 2 5 | Shtrirja e zhavorit 32/62mm në trashësi 30cm nën pllaken e perdheses. | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| **3** | **HIDROIZOLIMI** | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| 3 1 | Punimi I hidroizolimit ne pllake te themelit me kondor 4.0mm | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| 3 2 | Punimi I hidroizolimit ne mure te perimetrike te themeleve me kondor 4.0mm si dhe mbrojtesi I hidroizolimit | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| **4** | **ELEKTRIKA,IT** | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| 4.1 | KABLLOT ENERGJETIKE (funrizimi kryesor) | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| **5** | **UJESJELLESI DHE KANALIZIMI** | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 5.1 | Punimi I rrjetit te jashtem dhe hidrantit | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| 5.2 | Punimi I rrjetit te kanalizimit * vertikalet (ne perdhese | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| 5.3 | Punimi I furnizimit te rrjetit te ujesjellesit | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |
| 5.4 | Mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar, në shtresa me trashësi 20-30cm, me ngjeshen e nevojshme | | 3/Jan/26 | 1/May/26 | 119 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **FAZA III** | | **5/Jun/27** | **1/Oct/27** | **119** |
| 1 | PUNET E ARMIMIT | | 5/Jun/27 | 1/Sep/27 | 89 |
| 1.1 | Pllaka e perdheses | | 5/Jun/27 | 1/Sep/27 | 89 |
| 1.2 | Shtyllat dhe trajet - Perdhese | | 5/Jun/27 | 1/Sep/27 | 89 |
| 1.3 | Shkallet | | 5/Jun/27 | 1/Sep/27 | 89 |
| 1.4 | Pllaka e katit | | 5/Jun/27 | 1/Sep/27 | 89 |
| 1.5 | Pllaka Kulmit | | 5/Jun/27 | 1/Sep/27 | 89 |
| 2 | PUNET E CELIKUT | | 5/Jun/27 | 1/Sep/27 | 89 |
| 2.1 | Shtyllat Kryesore | | 5/Jun/27 | 1/Sep/27 | 89 |
| 3 | PUNET E BETONIT | | 1/Sep/27 | 1/Oct/27 | 31 |
| 3.1 | Pllaka e perdheses | | 1/Sep/27 | 1/Oct/27 | 31 |
| 3.2 | Furnizimi me material dhe punimi I fer-betonit ne dyshemet e komplet fabrikes (ne te gjitha njesite punuese) | | 1/Sep/27 | 1/Oct/27 | 31 |
| 3.3 | Shtyllat dhe trajet - Perdhese | | 1/Sep/27 | 1/Oct/27 | 31 |
| 3.4 | Pllaka e katit | | 1/Sep/27 | 1/Oct/27 | 31 |
| 3.5 | Pllaka Kulmit | | 1/Sep/27 | 1/Oct/27 | 31 |
| 4 | TERMOIZOLIMI | | 1/Sep/27 | 1/Oct/27 | 31 |
| 4.1 | Montimit I termoizolimit pergjate themelit | | 1/Sep/27 | 1/Oct/27 | 31 |
| 4.2 | Montimit I shtreses mbrojtese te termoziolimit pergjate themelit. | | 1/Sep/27 | 1/Oct/27 | 31 |
| | **FAZA IV** | | **5/Oct/27** | **30/Mar/28** | **178** |
| 1 | PUNET E CELIKUT | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.1 | Shtyllat kryesore | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.2 | Trau | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.3 | Brinaku | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.4 | Shtng Horizontale | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.5 | Shtng Diadonale | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.6 | Shtyllat sekondare | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.7 | Shtng ne pullaz | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.8 | Pllakezat monruese te shtyllave | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.9 | Pllakezat montuese te pullazit dhe shtangimeve | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 2 | PUNET E KULMIT | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.1 | Montimi I konstrukcionit nga materiali I drurit ne kulm te administrates | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.2 | Montimi I kulmit nga sandwich panelet | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.3 | Punimi I shtresave ne kulm, pambuk mineral 10cm ( 42kg/m2) | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.4 | Montimi I kulmarit nga llamarina e plastifikuar ne kulmit. | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.5 | Montimi I ullukut horizontal nga llamarina e plastifikuar ne kulmit. | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.6 | Punimi I termoizolimit te ulluqeve horizontal me sandwich panel. | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.7 | Montimi I ullukut vertikal nga llamarina e plastifikuar fi - 125mm. | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 1.8 | Montimi I pikoreve nga llamarina e plastifikuar ne dritare si dhe atike te ballkoneve | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 3 | MURET | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 3.1 | Punimi I mureve perimetrike | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |
| 3.2 | Punimi I mureve ndarese | | 5/Oct/27 | 30/Mar/28 | 178 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **FAZA V** | | **5/Apr/28** | **1/Jun/28** | **58** |
| 1 | **DRITARET** | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 2 | IT | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 2.1 | Rrjeti ne dysheme | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 3 | **ELEKTRIKA** | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 3.1 | Rrjeti ne dysheme | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 4 | **ALARMI** | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 4.1 | Rrjeti ne dysheme | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 5 | **UJESJELLESI DHE KANALIZIMI** | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 5.2 | Rrjeti ne dysheme | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 6 | **TERMIKA** | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 5.1 | Rrjeti ne dysheme | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 7 | **DYSHEME** | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 7.2 | Furnizimi me material dhe punimi I shtreses se termoizlomit | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 7.3 | Furnizimi me material dhe punimi I shtreses se nivelizimit me estrih | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 8 | **FASADA** | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 81 | Punimi I fasades nga Sandwichpaneli nga materiali termoizolues. | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 8.2 | Punimi I fasades nga Sandwichpaneli nga materiali termoizolues . | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 8.3 | Punimi i paneleve nga materiali. | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 8.4 | Punimi I termoizolimit ne fasade. | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 10 | **SUVATIMI** | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 9.1 | Suvatimi të gjitha mureve të brendshme , shtyllave dhe plafoneve, sipas specifikimit në projekt, me llaq te gatshëm ne **perdhese** **dhe kat**. | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 11 | **HIDROIZOLIMI** | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 11.1 | Hidrozolimi I mureve | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| 11.2 | Hidroizolimi dyshemese | | 5/Apr/28 | 1/Jun/28 | 58 |
| **FAZA VI** | | | **5/Jul/28** | **1/Sep/28** | **59** |
| 1 | **MURET** | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 1.1 | GLETIM | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 1.2 | NGJYROSJE | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 2 | **DYSHEMEJA** | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 2.1 | Epoxi | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 3 | **DYER DHE DRITARE** | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 3.1 | MURE XHAMI | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 3.2 | DYERT | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 4 | **ELEKTRIKA** | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 4.1 | PRIZA | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 4.2 | NDRICIMI | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 5 | IT | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 5.1 | Priza | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 5.2 | Serveri | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 6 | **ALARMI** | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 6.1 | Senzore | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 7 | **UJESJELLESI DHE KANALIZIMI** | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 7.1 | Sanitarit | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 8 | **MOBILE** | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 8.1 | Tavolia,karrike,dollapa | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 9 | **PAJISJET TEKNIKE** | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 9.1 | Pajisjet e përkthimit simultant | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 9.2 | Projektorët | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 9.3 | Audio pajisjet | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |
| 9.4 | Montazhat | | 5/Jul/28 | 1/Sep/28 | 59 |

Bosfort Berisha B. I.
N. SH.
A.M.C.
PRISHTINË



REPUBLIKA E KOSOVËS — РЕПУБЛИКА КОСОВО — REPUBLIC OF KOSOVO
LETËRNJOFTIM — ЛИЧНА КАРТА — IDENTITY CARD

Mbiemri / Презиме / Surname
BERISHA
Emri / Име / Given name
BESFORT
Datëlindja / Датум рођења / Date of birth
06.03.1986
Gjinia / Пол / Sex
M
Shtetësia / Држављанство / Nationality
KOSOVAR
Data e skadimit / Датум истека / Date of expiry
16.12.2024
Vendlindja / Место рођења / Place of birth
PODUJEVË
Nënshkrimi / Потпис / Signature

799288



IDRKSID0228870<<<<<<<<<<<<<<<
8603061M2412160RKS1500991301<5
BERISHA<<BESFORT<<<<<<<<<<<<<

PRISHTINË
ID0228870
1500991301
MPB / MUP / MIA
17.12.2014

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

# ARBK

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVO BUSINESS REGISTRATION AGENCY

## CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
## CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
## CERTIFICATE OF REGISTRATION

**810926701**

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

**Besfort Berisha B.I.**

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

**N.SH. "A.M.C"**

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

| | |
|---|---|
| Lloji biznesit:<br>Poslovni tip:<br>Business type: | Biznes Individual<br>Individualno preduzeće<br>Individual business |
| Adresa:<br>Adresa:<br>Address: | Lagja Dardania Nr.1/5,1/6 1/7 Zona I<br>Prishtinë |
| Data e regjistrimit:<br>Datum registracije:<br>Date of registration: | 19/11/2012 |

07/03/2019

Data / Date / Datum

Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10005543

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC

## Formulari per kerkese apo ankese

**Drejtorati/Njesia**
Kryetari Komunes

**Data** 28/07/2020

Mos shkruani në këtë pjesë

**Numri i protokolit**
02-070/05-0013910/20

**Afati i zgjedhjes**
27/08/2020

**Vendimi**

**1.Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:**

**Emri dhe mbiemri**
Besfort Berisha BI

**Numri personal**
810926701

**Adresa e vendbanimit**
Lagja Dardania nr 1/5,1/61/7 zona Prishtinë

**E-mail Adresa**

**Numri i tel. fiks**

**Numri i tel. mobil**
044-999-444

**Vlera për pagesë:** 0.00

**2. Mënyra e pranimit**
Kërkesa

**Statusi i lëndës**
Ne proces

**3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:**

Kërkesë per marrje eshfrytzimit te prones

**4. Dokumentet e bashkangjitura:**

**Nr.** **Lloji i dokumentit**

**5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi**

Unë Besfort Berisha BI vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkoni nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkese dhe dokumenteve të bashkangjitura

**Pranuar nga:** sala.paci

# Informata mbi biznesin
# Information about business
# Informacija o biznisu

## Numri unik identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
810926701

### Aplikacioni / Application / Aplikacija

| | |
|---|---|
| Subjekti i regjistrimit:<br>Registration subject:<br>Subjekt registracije: | |
| Data e plotësimit:<br>Filling date:<br>Datum: | 19/11/2012 |
| Data e pranimit:<br>Reception date:<br>Datum primljenje: | 19/11/2012 |
| Numri i protokollit:<br>Protocol number:<br>Broj protokola: | 19B0007432 |

### Biznesi / Business/ Biznis

| | |
|---|---|
| Tipi i biznesit<br>Business Type<br>Tip biznisa | Biznes Individual<br>Individual business<br>Individualno preduzeće |
| Emri i biznesit:<br>Business name:<br>Naziv biznisa: | Besfort Berisha B.I. |
| Adresa<br>Address<br>Adresa | Lagja Dardania Nr 1/5,1/6 1/7 Zona I<br>Prishtinë |
| Data e themelimit:<br>Date of establishment:<br>Datum osnivanja: | 19/11/2012 |
| Kapitali i përgjithshëm:<br>Total Capital:<br>Totalni kapital: | € |
| Numri i punëtorëve:<br>Number of employees:<br>Broj radnika: | 1 |

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri unik identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
810926701

Shënim me rëndësi / Important Note / Vazan podatak

, Numri mëparshëm i biznesit është NRB: 70899760 , me zbatimin e ligjit për numrin unik te identifikues te biznesit ka kete numër NUI: 810926701

Informata plotësuese / Additional Information Note / Dodatna informacija

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

**Numri unik identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number**
**810926701**

**Veprimtaritë / Activities / Delatnosti**

| | | |
|---|---|---|
| 7739 | Aktiviteti kryesor i biznesit | Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e makinerisë, pajisjeve dhe artikujve të tjerë të luajtshëm p.k.t.<br>Rental and leasing of other machinery, equipment and tangible goods n.e.c.<br>Iznajmljivanje i davanje u zakup (leasing) ostalih strojeva, opreme i materijalnih dobara, d. n. |
| 9609 | Aktivitetet tjera | Aktivitetet e tjera p.k.t.<br>Other personal service activities n.e.c.<br>Ostale licne uslužne delatnosti, d. n. |
| 9329 | Aktivitetet tjera | Aktivitetet e tjera të argëtimit dhe rekreacionit<br>Other amusement and recreation activities<br>Ostale zabavne i rekreacijske delatnosti |
| 9003 | Aktivitetet tjera | Krijimtaria artistike<br>Artistic creation<br>Umetničko stvaralaštvo |

**Filialet / Branches / Jedinice**

**Bordi drejtorëve / Board of Directors / Upravni odbor**

**Pronarët / Owners / Vlasnici**

Person fizik

| | |
|---|---|
| Emri:<br>Name:<br>Ime: | Besfort Bariqha |
| ID Personale:<br>Personal ID:<br>Licni ID: | 1500991301 |
| Adresa:<br>Address:<br>Adresa: | Lagja e Universitetit nr.47<br>Prishtinë |
| Përgjegjësia:<br>Liability:<br>Odgovornost: | |
| Pjesa në pronë:<br>Owned part:<br>Deo o vlasnistvu: | |
| Data e lindjes:<br>Date of birth:<br>Dan rodjenja: | |

## Informata mbi biznesin
## Information about business
## Informacija o biznisu

**Personat e autorizuar / Authorized participants / Ovlascene lice**

| | |
|---|---|
| Emri:<br>Name:<br>Ime: | Besfort Berisha |
| ID Personale:<br>Personal ID:<br>Licni ID: | 1500991301 |
| Pozita e punës:<br>Job position:<br>Radno mesto: | Agjent i Regjistruar |
| Adresa:<br>Address:<br>Adresa: | Lagja Dardania Nr 1/5,1/6,1/7 1<br>Prishtinë |

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE – MINISTARSTVO ZA FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

# ÇERTIFIKATË - DEKLARUES I TVSH
# UVERENJE - OBVEZNIK ZA PDV
# CERTIFICATE - VAT FILER

| | |
|---|---|
| Numri<br>Broj<br>Number | 330265357 |
| Numri Fiscal<br>Fiskalni Broj<br>Fiscal Number | 600857083 |
| Emri i personit<br>Ime osobe<br>Person's Name | N.SH. " A.M.C " |
| Adresa e Personit<br>Adresa osobe<br>Person's Address | Lagja e Universitetit nr.47· PRISHTINË PRISHTINË KOSOVA |
| Data e Regjistrimit<br>Datum Registracije<br>Registration Date | 23-03-2015 |
| Data e Lëshimit<br>Datum Izdavanja<br>Date of Issuance | 24-04-2015 |
| Personi Përgjegjës<br>Odgovorno Lice<br>Responsible Person | |

REPUBLIKA E KOSOVËS O.SH.T. PRISHTINË

Kjo certifikatë është lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-146 per Tatimin mbi vlerën e shtuar

Ovaj certifikat izdat je od Poreske Administracije Kosova, shodno Zakona Br. 03/L-146 O Porezu na Dodanu Vrednost.

This certificate is issued by the Tax Administration of Kosovo, based on the Law Nr. 03/L-146 on Value Added Tax.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
*REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO*

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË**
*OSNOVNI SUD PRIŠTINA*

***DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE***
*DEPARTMAN ZA EKONOMSKA PITANJA*

**Agj.nr. 3008/20**

**Me datë –Datuma 24.07.2020**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Ekonomike**, në bazë të
*OSNOVNI SUD U PRIŠTINI-Departman za privredna pitanja, na osnovu zahteva stranke, u smislu*
kërkesës së palës, në kuptim të nenit 12 paragrafi 2.10 i Rregullores për Organizimin e Brendshëm
*člana 12, stav 2.10 Pravilnika o unutrašnjoj organizaciji*
të Gjykatave e datës 4.1.2013, lëshon këtë:
*Sudova izdaje sledeće:*

## ÇERTIFIKATË

## UVERENJE

Në regjistrat e Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë,
*U registrima Departmana za privredna pitanja Osnovnog suda u Prištini*
Nuk ka - evidencë se operatori ekonomik **Besfort Berisha B.I., N.SH. "A.M.C" Prishtinë**, me numër biznesi **810926701.**

*nema dokaza da je ekonomski* operater

Nuk është - shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy viteve të kaluara, dhe ndaj të njëjtit
*Nije proglašen pod stečaj ili nelikvidan u protekle dve godine, i protiv istog*

nuk është - e iniciuar procedura e falimentimit përkatësisht e likuidimit .
*nije – pokrenut postupak stečaja odnosno raspuštanja /likvidacije/.*

Kjo Çertifikatë lëshohet në kuptim të nenit 65 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1 dhe 4.2 i Ligjit
*Uverenje izdaje se na osnovu člana 65 stav 4 podstav 4.1 i 4.2 Zakona*
Nr.04/L-042 për Prokurorimin Publik në Republikën e Kosovës.
*br.04/L-042 o Javnoj Nabavci Republike Kosova.*

E njëjta është kërkuar nga pala me qëllim të pjesmarrjes në **Aplikim pë pronë komunale Obiliq.**
*Ista je tražena od stranke, sa ciljem učešća u tenderu*

dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera.
*i ne može se upotrebiti za druge svrhe.*

Taksa është paguar sipas Tarifës për taksa gjyqësore në shumë prej 5 €, e paraparë me nenin 12.17
*Taksa je plaćena po Tarifi za sudske takse u iznosu od 5 €, predviđeno članom 12.17*

të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së, nr. 1/2017, në fuqi nga data 1.5.2017.
*Administrativnog Upustva SSK-a, br. 1/2017, na snazi od dana 1.5.2017god.*

**Referenti i Gjykatës**
***Referent Suda***
**Afrim Ademi**

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

# VËRTETIM TATIMOR
# TAX VERIFICATION
# PORESKA POTVRDA

Administrata Tatimore e Kosovës verifikon se personi i identifikuar më poshtë:
Tax Administration of Kosovo certifies that the person identified below:
Poreska Administracija Kosova overava da dolje identifikaciono lice:

1000715668

| | |
|---|---|
| Emri i personit:<br>Name of Person:<br>Ime lice: | Besfort Berisha B.I. |
| Numri Identifikues Personal:<br>Personal Identification Number:<br>Identifikacioni Lični Broj: | 1500991301 |
| Numri Fiskal:<br>Fiscal Number:<br>Fiskalni Broj: | 810926701 |
| Komuna:<br>Municipality:<br>Opština: | PRISHTINË |
| Data:<br>Date:<br>Datum: | 25.06.2020 |
| Arsyeja e lëshimit:<br>Reasoning:<br>Razlog izdavanja: | Aplikim për Tender |

ka këtë gjendje tatimore në ATK:
has the following tax position with the TAK:
ima sledeću poresko stanje u PAK:

Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura
This person is registered with TAK and is currently in an installment agreement to satisfy outstanding tax debts
Lice je registrovana u PAK i aktuelno je u sporazumu u ratama za isplatu ostalih poreskih dugova

ATK vërteton se informatat e dhëna janë të sakta dhe të plota me datën e këtij vërtetimi tatimor, mirëpo, ky vërtetim nuk përjashton obligimet tatimore që mund të lindin në të ardhmen.

ATK certifies that this information is correct and complete as of the date of this verification, but this verification does not exclude future tax obligations.

PAK overava da su date informacije tačne i potpune sa datumom ove potvrde, ali ova podvrda ne isključuje poreska obaveza koja mogu nastati u budućnosti.

Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit
The verification is valid for 90 days from the day it is issued
Potvrda vazi 90 dana od dana kada je izdata

Verifikimin e këtij vërtetimi tatimor, mund ta bëni në linkun -
Verification of this tax verification, you can do on the link - Verifikaciju ove poreske potvrde, možete uveravati i linku:
https://eVertetimi.atk-ks.org/TaxVer/ReadTaxVer

Nr Formes VT - 2, Korigjuar më 30.04.2013

| | Republika e Kosovës<br>Republika Kosova – Republic of Kosovo<br>Qeveria – Vlada – Government<br><br>Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova<br>Ministry of Internal Affairs<br><br>Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police | |
|---|---|---|
| | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/<br>Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate | |

Nr. Rendor/Redni br./Ordinal no: 141/20

## VËRTETIM POTVRDA CERTIFICATE

Në mbështetje të nenit 31 paragrafi 10 të Ligjit për Policinë dhe nenit 98 paragrafi 5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, personit të poshtë shënuar, i është bërë verifikimi në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës, dhe jepet

U skladu sa članom 31 stav 10 Zakona o Policiji i člana 98 stav 5 Krivičnog Zakona Republike Kosova, dole navedene osobe, je izvršena provera prošlosti u Obaveštajnim Sistemu Policije Kosova. i izdaje se

Pursuant to the article 31 paragraph 10 of the Law on Police and article 98 paragraph 5 of the Criminal Code of the Republic of Kosovo, the below mentioned person, was conducted the verification in the Kosovo Police Information System, and is issued

Vërtëtohet se:
Potvrdjuje se da:
It is certified that:

| | |
|---|---|
| *Mbiemri/ Prezime/Surname:* | **BERISHA** |
| *Emri/ Ime/ Name:* | **BESFORT** |
| *Mbiemri i vajzërisë/Devojačko prezime/Maiden Name* | ////// |
| *Data e lindjes/ Datum rodjenja/ Date of birth:* | **06.03.1986** |
| *Adresa/ Adresa/ Address:* | **LAGJA UNIVERZITETIT NR/47-PRISHTINË** |
| *Vendi i lindjes/ Mesto rodjenja/ Place of birth* | **PODUJEVË** |
| *Emri i babës/ Ime oca/ Father's name* | **JUSUF** |
| *Nr. Lnj / Br. lk / Id.no* | |
| *Nr.personal i lnj / Licni broj / Personal number* | **1500991301** |
| *Nr. i pasaportës/ Br. pasosa/ Passport no.* | |

**Nuk ka dosje penale në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës.** **Datë/ Datum/ Date: 29.06.2020**
**Nema kriminalni dosije u Obaveštajni Sistem Policije Kosova.**
**There is no criminal background in the Kosovo Police Information System.**

**Arsyeja e dhënies - Razlog izdavanja - Reasoning: KY VËRTETIM LËSHOHET VETËM PËR PUNËSIM NDËRSA I NJËJTI NUK PËRDORET PËR QËLLIME TJERA**

**Njësiti I SIPK-së / Drejtoria e Policisë: PRISHTINË**
**Jedinica ISPK-a / Direkcija Policije:**
**KPIS Unit / Directorate of Police:**

**Stacioni Policor/Policijska Stanica/ Police Station: JUGU-PRISHTINË**

**Komandanti i Stacionit/Komandir Stanice/ Station Commander: MAJOR :V.HOTI**
(apo i autorizuari i tij/ ili njegov ovlaščenik/ or his authorized)

---

Verifikuar në SIPK ,DRP nga/ Provera u ISPK-u, RDP u / Verified in KPIS, RPD by: **SC#1282**
Plotësuar në SP nga/ Popunjeno u PS u./Completed SP by: **SABINA SHIPOLI # 6746**

N.SH A.M.C
Besfort Berisha B.I
NUI: 810926701

NF:600857083
NRB:70899760
Tel: +383(0)44 999 444

Adresa: Lagjja Dardania 1/5 1/6 1/7
Qyteti: Prishtinë
Kontakt: besfortberisha@gmail.com

# Kërkesë

Drejtuar: Kryetarit të Komunës së Obiliqit

Z. Xhafer Gashi

Tema: Kërkesë për marrje në shfrytëzim të prones së komunë së Obiliqit

I nderuar zoti Kryetar,

Po ju drejtohemi me kërkesë për marrjen e të drejtës për shfrytëzim të një parcele në Zonën Industriale të Komunës së Obliqit, në Lokacionin e quajtur Llazarevë, me qëllim të investimit në një projekt kulturor, që do të jetë me interes jo vetm të investitorit por edhe të Kumunës dhe qytetarëve të saj.

Kompania me emrin tregtar N.SH A.M.C me të dhënat tjera sipër dhe përfaqësues Besfort Berisha me NP: 1500991301 planifikon të bëjë një investim për krijimin e një qendre multifunksionale në të cilën veprimtaria kryesore do të jetë organizimi i koncerteve por do ketë edhe skenë mobile per shfaqje teatrale, skenografi mobile televizive, xhirime profesionale dhe krijimtari të ndryshme kulturore, artistike,muzikore dhe educative.

Faza e parë e investimit planifikohet të jetë ndërtimi i objektit me bazë 80m x 40m. Salla kryesore është e projektuar të jetë me dimensione 70m x 40m me lartesi 12m ( Lartësia minimale 10m nga baza) ndërsa 10m x 40m ne 3 nivele, pra gjithsej 1200m2 janë të paraparë për objektin administrative. Ky investim kap vlerën e 1.6 milion euro duke përfshirë edhe pajisjet teknike si skenat mobile, zërimi, ndricimi dhe LED Ekrani.

Objekti do të jetë me standarde profesionale edhe për koncerte ndërkombëtare duke përfshirë: Daljet emergjente, alarmet kundër zjarrit, klimatizimin, toaletet, pesha bartëse e catisë për varjen e pajisjeve teknike si Zerim, Ndricim, Led ekrane etj.

Objekti planifikohet të fillohet të ndërtohet nga qërshori i vitit 2021. Ndërtimi dhe kompletimi i objektit me pajisjet e nevojshme teknike si ( zërimi, ndricimi, ekranet etj.) planifikohet të zgjasë 3 vite pas të cilës kohë planifikohet të fillon operimi i plotë i qendrës.

Pas vitit të 5-të të fillimit të investimit, planifikojmë që objektit ekzistues ti bashkangjitet edhe një objekt shtesë me dimensione 40m x 40m e ngritur 6m nga toka ku do të ketë hapsira për trajnim të stafit, hapsira për studio zëri, hapësira për xhirime profesionale, depo etj.

Vlera e këtijë investimi shtesë do të jetë 400.000 Euro

Qendra do të ketë staf shumë professional të të gjitha fushave si (mjeshtër ndricimi, mjeshtër skene, drejtor fotografie, regjisor, mjeshtër kamere, mjeshtër zëri, organizator, etj) dhe në dy vitet e para do të punësojë 30 përsona që do të trajnohen në fusha të ndryshme si kameraman, tonist, ndricues etj.

Nga parcelat në parkun industrial, ne jemi të interesuar për marrje në shfrytëzim afatgjatë të parcelës nr: **124-17 që ka madhësi prej 17262m2**

Qendra në total do ti ketë 5600m2 objekt të ndërtuar, me sipërfaqe të parkingut të rregulluar prej 6000m2 si dhe pjesa tjetër e hapësires, rreth 6000m2,do të kufizohet dhe do të përdoret për organizimin e festivaleve të ndryshme gjatë vitit.

Përpos investimit prej mbi 2 milion euro deri në vitin 2026, në këtë qendër do tëpunësohen qysh në vitin e parë të hapjes së qendres deri 20 persona vetëm nga Komuna e Obiliqit, ndërsa pas jo me vonë se 12 muaj pas fillimit të punës edhe 10 përsona të tjerë.

Me marrëveshje paraprake me Komunën e Obiliqit, qendra mund të ipet në shfrytëzim pa pagesë edhe për ndonje ngjarje të Komunes si p.sh. ndonje panair, koncert, ngjarjet e datave të caktuara kalendarike, për aktivitete lidhur me diasporë, apo evente tjera publike kulturore dhe edukative, që organizohen dhe menaxhohen nga Komuna.

Qendra do t'i mundësojë të gjithë nxënësve të shkollave fillore dhe të mesmë të komunës së Obliqit që në mënyrë të organizuar ta vizitojnë qendren dhe shohin nga afër se si përgatitet teknikisht një koncert ose ngjarje tjetër kulturre e artistike. Gjithashtu, qendra mund të jetë në dispozicion të nxënësvë që do të përzgjedhën nga institucionet e Komunës së Obiliqit për

të provuar talentet e tyre në këndim dhe moderim televiziv dhe në bashkëpunim me menaxhuesin e qedrës, të organizohet vlerësimi nga profesionist të fushave, kurse fituesve të garave të këndimit, të iu mundësohet komponimi dhe incizimi i këngës dhe klipit, në shpenzime të Kompanisë menaxhuese të qendrës.

Meqë kompania jonë ofron edhe dhënje me qira të pajisjeve teknike për koncerte si: zerim, ndricim, led ekrane dhe skena, ne jemi të gatshëm që Komunës së Obiliqit të ja ofrojme pa pagese në 10 vitet e ardhshme të gjtha pajisjet e nevojshme teknike për 3 koncerte 1 ditore gjatë vitit si: Skenë e mbuluar me dimensione 12 x 10, Zerim per live bande, Ndricim profesional dhe LED ekrane,vlera reale e te cilave ne treg është rreth 5000 Euro për një concert apo ngjarje.

Mbesim me shpresë që do gjejmë mbështetjen tuaj në ndërtimin e kësaj qendre me standard të larta dhe vlera të larta kulturore dhe artistike dhe mbesim të hapur për të biseduar për cdo detaj që do ishte në interesin e komunes suaj.

Me respekt

Besfort Berisha,

Pronar dhe Drejtor Ekzekutiv

A.M.C.

NDËRMARRJA SHËRBYESE A.M.C PRISHTINË

BYESE

# Plan Ideor

Ky Draft ideor është përgatitur për Komuna e Obiliqit nga:

amc

**Korrik 2020**

# Përmbledhje ekzekutive

A.M.C. (Artist Management Company "Kompania e Menaxhimit të Artistëve") e themeluar në vitin 2012, është kompani e specializuar e cila si shërbim ofron zgjidhje të shumta për evente (ngjarje/manifestime), që nga evente të vogla si konferencat e panairet, e deri te shërbime madhore e shumë të specializuara si festivalet e mëdha dhe koncertet. A.M.C. ofron shërbime të shumëllojshme si zgjidhje për evente, siç janë ndërtimi i skenës, ndriçimi, pajisjet led, si dhe sistemet e zërimit. Kompania jonë është lider në industrinë e shërbimeve të zgjidhjeve për evente në Kosovë dhe është konkurrent i fortë në Shqipëri dhe Maqedoni.

Tregu i argëtimit në Kosovë dhe në rajon është rritur dukshëm gjatë dekadës së fundit, gjë që ka ardhur si rezultat i zbutjes së tensioneve politike midis vendeve të ish-Jugosllavisë në Evropën jug-lindore. Me kalimin e viteve, dhe me rritjen e stabilitetit në rajon pas luftërave të Jugosllavisë, tregu i organizimit të eventeve lulëzoi, dhe u themeluan shumë festivale muzikore dhe filmike, si dhe filluan të zhvillohen evente tjera kulturore dhe ekonomike krahas me zhvillimin e rajonit. Sot, rajoni i Ballkanit shihet si rajon në zhvillim, i cili ka stabilitet politik në Evropë dhe është në rrugë drejt Bashkimit Evropian. Rajoni tërheq shumë individë në qytetet e këndshme e të thjeshta që ka, si dhe tek luginat e bukura dhe peizazhet malore, dhe vizitorët vijnë për të marrë pjesë në lloje të ndryshme eventesh. Kohët e fundit Kosova ka shënuar rritje të kërkesës për evente kulturore dhe afariste, gjë që dëshmohet nga ngjarjet e shumta që janë mbajtur kohët e fundit.

Eventet që kompaninë A.M.C e bëjnë krenarë janë të shumta dhe sigurisht në vend të parë është Koncerti për 10 vjetorin e pavarësisë së Kosoves ku ka performuar këngetarja shqiptare Rita Ora dhe A.M.C ka qenë e kontraktuar nga Qeveria e Kosovës për të aranzhuar performancën e artistes, përmbushjen e kërkesave teknike të menagjmentit të artistes, sigurinë private të eventit , transportin e pajisjeve personale të bendit dhe kontraktimin e avionëve privat për gjithë ekipin e RITA ORA,

Koncerti i Rita Ora në Tiranë po atë vitë ka qenë i organizuar nën mbikqyrjen e A.M.C dhe është furnizuar me pajisje teknike dhe ka qenë kërkesë e panegocuar nga menagjmenti i artistes që eventi duhet të menagjohet nga A.M.C

Koncerti i Ermal Meta në Tiranë ka qenë një koncert i jashtëzakonshëm ku A.M.C ka realizuar pjesën teknike të Zërimit, Ndicimit dhe konstruksioneve

Në vitin 2019 Capital T ka realizuar një koncert me një kosto mbi 250.000 Euro në Tiranë dhe A.M.C është kujdesur për pjesën teknike të zërimit.

Realizimi i thuajse të gjitha eventeve madhore në kosovë janë realizuar teknikisht nga A.M.C si Beer Festival, Anibar, Beer and wine Festival, The summit festival, Prifilm Fest etj.

A.M.C ka për bashkëpunëtor të gjitha televizionet në vend si RTK, KLAN Kosova, KTV, RTV21, Dukagjini, T7, First Channel etj. Dhe ka realizuar teknikisht qindra emisione televizive për këta klientë.

Panairet e ndryshme të organizuara nga: Modus (Auto Show), CEO (Panaire te shumta ndër vite), Oda Ekonomike e kosoves ( Panairet e ndryshme ), Base Agency ( Panaire, Kampanja, emisione televizive etj.) kanë huazuar të gjitha pajisjet teknike në thuajse të gjitha organizimet e tyre.

Konferencat vendore por edhe ato të njohura ndërkombëtare të organizuara nga STIKK janë realizuar teknikisht nga A.M.C

Me rritjen e tregut të eventeve në Kosovë, A.M.C ka filluar një proces të ri zgjerimi duke bërë një plan investimi të ri i cili pritet të ngrisë sasinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga kompania dhe zgjëroje prezencën e përgjithshme në treg në Kosovë dhe rajon, duke rritur të ardhurat.

Investimet e reja që ka planifikuar kompania janë pjesë e bazës së shërbimeve të saja, si dhe paraqesin zgjerim të shërbimeve jashtë bazës shërbyese të saj, përmes investimeve dhe përdorimit të aseteve e shërbimeve ekzistuese të kompanisë. Investimi i ri i kompanisë është ndërtimi i një qendre multifunksionale që synon të jetë qendra më e madhe private në vend dhe rajon e cila do të detajohet më poshtë si:

- OBJEKT MULTIFUNKSIONAL

Investimi në objektin multifunksional pritet të fillojë në qershor 2021 dhe përfundimi i ndërtimit pritet më së largu deri në qërshor të vitit 2024. Investimi vlerësohet të kushtojë në total 2 milion Euro, duke përfshirë të gjitha kostot e ndërtimit dhe shpenzimet e lejeve.

Rritja totale e të ardhurave nga këto investime pritet të jetë rreth 300,000 Euro në vit, ose rritje prej 50% nga veprimtaria e zakonshme biznesore. Me investimet e reja kompania do të jetë në gjendje të sigurojë të ardhme të qëndrueshme në Kosovë, si dhe të rrisë mundësitë e saj të zgjerimit në rajon, duke fuqizuar reputacionin e saj si një nga kompanitë kryesore të shërbimeve për evente, si dhe të gjenerojë mundësi të reja për rritjen e të ardhurave përmes tërheqjes së kompanive për të investuar në koncerte dhe festivale me artistë vendor e ndërkombëtarë.

# Prezantim i kompanisë

A.M.C. (Artist Management Company "Kompania e Menaxhimit të Artistëve") është themeluar në vitin 2012 në Prishtinë, Kosovë. Kompania është kompani e specializuar e cila si shërbim ofron zgjidhje të shumta për evente (ngjarje/manifestime), që nga evente të vogla si konferencat e panairet, e deri te shërbime madhore e shumë të specializuara si festivalet e mëdha dhe koncertet. A.M.C. ofron shërbime të shumëllojshme si zgjidhje për evente, siç janë ngritja e skenës, ndriçimi, pajisjet led, si dhe sistemet e zërimit. Kompania jonë është lider në industrinë e shërbimeve për evente në Kosovë dhe është konkurrent i fortë në Shqipëri dhe Maqedoni.

## Vizioni dhe Misioni

Vizioni i kompanisë është që gjithmonë të jetë krye-qendër për planifikim të eventeve, falë ofrimit të shërbimeve cilësore për klientët e saj me çmim të arsyeshëm. Prandaj, kompania investon në masë të madhe në teknologji dhe pajisje të fjalës së fundit për zërim, led, ndriçim dhe skenë, si dhe siguron vazhdimisht që shërbimet të jenë më të mira dhe me kosto efektive, me theks të veçantë në ofrimin e shërbimeve për të gjitha llojet e pakove të zgjidhjeve, me cilësi të lartë, dhe në kohë rekord.

## Objektivat e kompanisë

- Ofrimi i shërbimeve me cilësinë më të lartë në Kosovë dhe në tregjet e shteteve fqinje.
- Përmbushja e kënaqësisë së klientit në nivele të larta.
- Investimi në shërbime të reja dhe mbajtja e pozitës si lider i tregut.
- Përmirësimi i performancës së kompanisë në saje të ekonomive proporcionale.
- Përmirësimi i marzhës së fitimit neto dhe qarkullimit të të ardhurave.

## Faktorët kryesorë të suksesit

- Menaxhmenti i lartë ka aftësi të mira falë përvojës së gjerë në menaxhim të planifikimit të eventeve.
- Dedikimi ndaj përmbushjes së të gjitha nevojave në shërbim të klientit.
- Çmimet konkurruese.
- Mirëmbajtja e shërbimeve stabile profesionale, ofrimi i produkteve me cilësi të lartë dhe ofrimi i produkteve në kohë rekord.

# Shërbimet

A.M.C. aktualisht ofron shërbime për pjesën dërmuese të tregut të menaxhimit të eventeve, duke shërbyer si one-stop-shop pra si dyqan që ofron çdo lloj zgjidhje për evente. Kompania ofron ndërtim të skenës; si dhe ndriçim, pajisje led dhe sisteme zërimi, të gjitha të teknologjisë më të fundit. Kompania aktualisht përdor asetet e saja të shumta në mënyrë që të tërheqë klientë vendorë, meqë ata janë në gjendje të ofrojnë pako-marrëveshjeje më të mira sesa konkurrentët e tjerë të vegjël në treg të cilët ofrojnë vetëm shërbime specifike. Kompania e ka parasysh që për të vazhduar mbajtjen e pozitës së liderit në tregun e eventeve në Kosovë është e domosdoshme që vazhdimisht të arrijë risi në shërbimet që ofron momentalisht dhe se duhet të përpiqet të zgjerojë spektrin e shërbimeve të mundshme për klientët potencialë.

Si pjesë e procesit të ri të zgjerimit të A.M.C., janë planifikuar tre investime të reja të cilat pritet të rrisin edhe nivelin e shërbimeve që ofron kompania por edhe prezencën totale të saj në tregun e Kosovës dhe të rajonit, duke rritur në anën tjetër fitimin potencial, si dhe duke arritur ekselencë më të lartë të ofertës së kompanisë.

Investimet e reja që ka planifikuar kompania janë pjesë e bazës së shërbimeve të saja, si dhe paraqesin zgjerim të shërbimeve jashtë bazës shërbyese të saj, përmes investimeve dhe përdorimit të aseteve e shërbimeve ekzistuese të kompanisë. Investimet e reja të kompanisë janë:

- Ndërtimi i Qendrës multifunksionale

## Shërbimet e Qendrës multifunksionale

Rezultatet nga studimi i tregut që është bërë për qëllimet e këtij projekti tregojnë se tregut të Kosovës i mungon hapësira adekuate për salle multifunksionale. Kërkesa është e lartë për këtë shërbim nga kompanitë prodhuese të cilat përballen me vështirësi në gjetjen e hapësirës adekuate për studio, e cila mund të përmbushë kërkesat për lartësi dhe pajisje tjera përcjellëse si ndriçim, zërim, LED Ekrane, skena mobile etj.. Prandaj, nevoja për të ndërtuar dhe menaxhuar një hapësirë multifunksionale me standardin më të lartë në treg, e cila ka edhe si përparësi faktin se ka skenë, ndriçim dhe pajisje led në dispozicion paraqet dobi të madhe për klientët e A.M.C. dhe për spektrin aktual të shërbimeve bazë të kompanisë.

A.M.C. planifikon të investojë afërsisht 2 milion Euro sallen multifunksionale me sipërfaqe prej 2800 metër katror, dhe me hapësirë shtesë prej rreth 1,200 metra katrorë për hapësirë zyre ( Administrata) dhe 1600 metra katrorë hapësirë për salle operative. Madhësia e përgjithshme e kompleksit është vendosur të jetë 5600 metra katrorë.

Qendra do të jetë në shërbim për aktivitete të ndryshme si panaire, koncerte me artist vendor e ndërkombëtar, Xhirime televizive, prodhime artistike, shfaqje teatrale, promovime letrare, shfaqje e filmave e të gjitha organizimet tjera komerciale, kulturore e artistike.

## Investimet në Qendrën multifunksionale

Themelet e përgjithshme të qendres do të jenë të shtrira në një sipërfaqe prej 4800m2, në të cilen do të ndërtohet Salla Multifunksionale me dimensione 70m x 40m e ngritur 10m nga toka, Salla operative me dimensione 40m x 40m e ngritur 6m nga toka dhe zona administrative me dimensione 10m x 40m me përdhesë dhe dy kate sipër.

## Salla multifunksionale

Themelet e qendrës do të vendosen pas një studimi të detajuar të lokacionit duke u bazuar në rregulloret ndërkombëtare për lokacionet ku mbahen festivalet duke pas parasyshe të gjitha detajet si Evakuimet e turmave, Vërshimet atmosferike, intervenimet emërgjente etj.

Shtyllat mbajtëse të objektit do të ndërtohen nga betoni dhe muret nga brenda do të murosen me blloka betoni. Fasada e jashtme do të jetë strukture e tipit sandwich panel dhe strukture metalike për dekor të objektit.

Catia do të bëhet nga konstruksioni i metalit ku do të vendosen kapriata 2m të gjëra cdo 5m të cilat përveq koeficientit real të ndërtimit secila kapriatë peshë bartëse do të ketë 10T për të mundësuar varjen e pajisjeve lart.

Salla nga brenda do të jetë e rrethuar me materiale akustike difuzive dhe absorbuese ne mure dhe tavan duke plotësuar standardet akustike.

Objekti do të jetë me sistem antizjarr, Ventilim të mjaftueshëm dhe sistem klimatizimi.

Salla do të pajisjet me Sistem zërimi NEXO për 10.000 Përsona vlera investive e të cilit shkon në rreth 350.000 Euro duke u siguruar që fuqia prej 110DB të jetë në secilën pikë të salles.

Ndricimi artistik do të vendoset për nevojat e të githa veprimtarive që do të zhvilloj qendra dhe kosto investuese do të jetë rreth 300.000 Euro.

Qendra do të posedoj si asete të saja edhe minimum 150 m2 LED Ekran P4.8 për të mundësuar transmetime të ngjarjeve kulturore e sportive si dhe konferenca e panaire të ndryshme për të promovuar produkte të ndryshme. Vlera investuese rreth 200.000 Euro

Ulëset do të jenë lëvizëse për të mundësuar llojllojshmërinë e aktiviteteve dhe do të ketë mundësine e akomodimit të rreth 1500 përsonave. Vlera e investimit rreth 100.000 Euro.

Salla do të pajiset me gjenerator për të mundësuar funksionimin e aktiviteteve pavarësisht energjisë elektrike kur ajo mund të mungoj dhe vlera investuese rreth 25000 euro.

Regjia profesionale televizive do të instalohet ne pjesën e administrates dhe qendra do të ketë një vlerë të shtuar prej rreth 150.000 Euro.

## Administrata

Hapsira e dedikuar per menagjim të qendrës e quajtur administratë do të vendoset ne mes sallës multifunksionale dhe sallës operative e cila në total do të ketë 1200m2, e shpërndare në 3 nivele, ky do të vendoset regjia televizive, Zyrat e stafit, dhomat e takimeve, zhveshtoret, toaletet etj.

## Salla operative

Ndërtimi i sallës operative do të shtrihet në sipërfaqë prej 1600m2 dhe do të jetë e lartë 6m nga toka. Do të ketë hapsira të ndryshme për veprimtaritë që ndërlidhen me aktivitetet e qendres sic jane Salla për trajnime, dhomat e audio incizimit, dhomat e video produksionit, dhe një pjesë depo për nevojat e qendres.

Vlera e pajisjeve teknike që do të instalohen silet rreth 125.000 euro

Ndërtimi i qendres ( Salla multifunksionale dhe Administrata) është vendosur të fillojë në qërshor të vitit 2021 dhe të gjitha investimet pritet të përfundojnë më së voni deri në qërshor te vitit 2024. Salla multifunksionale fillon veprimtarinë në shtator të vitit 2024.

Ndërtimi i salles operative fillon ndërtimin në qërshor të vitit 2026 dhe përfundon ne shtator të vitit 2027.

## Zona e festivaleve Open Air

Në hapsirën prej rreth 6000m2 jasht qendres do të investohet në infrastrukturë për të mundësuar mbajtjen e festivaleve apo koncerteve jasht gjatë sezones verore e cila do të ketë rrethojë të nevojshme për të siguruar mbarvajtjen e eventeve të tipit open air përfshirë kinema verore etj.

## Parkingu

Qendra do të ketë rreth 6000m2 parking dhe rrugë qarkulluese.

## Analiza e tregut të Menaxhimit të Eventeve

Ky segment i analizës së tregut do të përfshijë Industrinë e Menaxhimit të Eventeve në Kosovë dhe rajon, duke u përqëndruar specifikisht në nxjerrjen e kërkesës për shërbime të eventeve në tregun kosovar siç janë zgjidhjet për ngritje skene, zërim dhe ndriçim si dhe shërbimet e ekraneve led. Gjersa A.M.C. operon në një nga zinxhirët e Industrisë së Menaxhimit të Eventeve, rritja e organizimeve të eventeve që janë mbajtur në Kosovë çon po ashtu në rritje të kërkesës për shërbimet e A.M.C.-së.

Tregu i argëtimit në Kosovë dhe në rajon është rritur dukshëm gjatë dekadës së fundit, gjë që ka ardhur si rezultat i zbutjes së tensioneve politike midis vendeve të ish-Jugosllavisë në Evropën jug-lindore. Një shembull ilustrues i kësaj është **EXIT Festival i** cili u themelua në vitin 2000 me synimin për të promovuar demokraci dhe liri në Serbi dhe në rajonin e Ballkanit, dhe i cili fillimisht kishte pjesëmarrje të vogël të koncert-shkuesve por u rrit dhe arriti të tërheq 200 mijë festival-shkues nga e gjithë bota në Novi Sad çdo vit. Fillimisht sllogani i festivalit në vitin e parë ishte "Dil (Exit) nga dhjetë vite çmenduri", gjë që i referohej sundimit të Milloshevigit në Jugosllavi. Me kalimin e viteve, dhe me rritjen e stabilitetit në rajon pas luftërave të Jugosllavisë, tregu i organizimit të eventeve lulëzoi, dhe u themeluan shumë festivale muzikore dhe filmike, si dhe filluan të zhvillohen evente tjera kulturore dhe ekonomike krahas me zhvillimin e rajonit.

Sot, rajoni i Ballkanit shihet si rajon në zhvillim, i cili ka stabilitet politik në Evropë dhe është në rrugë drejt Bashkimit Evropian. Rajoni tërheq shumë individë tek pamjet e thjeshta të qyteteve të veta, si dhe tek luginat e bukura dhe peizazhet malore, dhe vizitorët vijnë për të marrë pjesë në lloje të ndryshme të eventeve. Kohët e fundit Kosova ka shënuar rritje të kërkesës për evente kulturore dhe afariste, gjë që dëshmohet me eventet e shumta që janë mbajtur kohët e fundit. Vetëm vitin e kaluar Kosova ishte destinacioni kryesor i artistëve të famshëm ndërkombëtarë si Rita Ora, Dua Lipa, Action Bronson dhe Martin Garrix. Përveç këtyre artistëve ndërkombëtarë, Kosova është edhe nikoqire e festivaleve të mëdha kulturore dhe muzikore, ndër të tjerash si: Dokufest, Into the Park, Sunny Hill Festival, Bunar Fest dhe Summit. Rajoni në përgjithësi ka pranuar artistë më të famshëm që kanë performuar në festivale të ndryshme dhe tendenca akoma vazhdon me performanca nga artistë si Lenny Kravitz dhe Sting në Shkup të Maqedonisë. Vetëm këtë vit, EXIT është nikoqir i një nga formacioneve më të mëdha të performancës muzikore me bende e artistë të shquar.

Tregu i eventeve të panaireve biznesore ka shënuar gjithashtu rritje në aspekt të kërkesave meqë ka pasur industri të ndryshme organizuese të eventeve të panaireve për promovim produkteve dhe për prezantim produktesh ndërkombëtare në Kosovë dhe rajon. Në disa vitet e fundit, CEOKOS, një nga organizatorët kryesorë të panaireve në Kosovë ka organizuar 102 panaire, 240 konferenca, 60 seminare dhe 42 evente për palë të treta, që nga aktivitete biznesi, edukimi e deri te evente kulturore.

Kjo rritje e kërkesës në tregun e menaxhimit të eventeve në Kosovë dhe rajon sigurisht që do të reflektojë në rritjen e të ardhurave tek kompanitë që ofrojnë shërbime për evente, siç është A.M.C..

# Plani i investimit

Meqenëse të gjitha shërbimet e reja të listuara kërkojnë paraprakisht investime në asetet e kompanisë, më poshtë është paraqitur një tabelë kohore e investimeve, për të treguar se kur do të ndodhin investimet:

| Investimet | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| Qendra multifunksionale | 300.000 € | 300.000 € | 300.000 €- | 700.000 €- | - | - |
| Salla Operative | - | - | - | | 200.000 € | 200.000 € |
| **Investimet totale** | | | | | | **2.000.000 €** |

Investimet e paraqitura më lart janë shpërndarë mjaftueshëm në mënyrë që t'i lejojnë kompanisë të jetë në gjendje të financojë investimet përmes rrjedhës së lirë operacionale të parasë së gatshme krahas kredive që do të marrë kompania. Si e tillë, tabela e investimeve e paraqitur më sipër tregon kohën optimale për secilin investim që do të ndodhë gjatë periudhës së parashikuar gjashtë-vjeçare.

# maden group

## Qendra Multifunksionale



SALLA OPERATIVE

- ZONA TRAJNUESE
- STUDIO MUZIKORE
- POST PRODUKSIONI
- PIKE KONTROLLUESE
- KOMUNIKIMI ME AUTOMJETE
- NGROHJA
- FJETJA
- GARDEROBA, MAKE UP, TUSHE-KABINA

SALLA MULTIFUNKSIONALE

- SANITARI PER SHIKUES
- HYRJA E PUBLIKUT
- ZYRET E REGJISOREVE

ADMINISTRATA

- RECEPCIONI
- ZYRET E TAKIMEVE
- ZYRET E STAFIT
- SANITARIT
- KUZHINA



# KERKESA

# KONCEPTI




04- Diagrami

maden group


Salla operative
Salla multifunksionale
Administrata
Salla operative



maden group


niveli +330
Holli
06- Administrata
maden group

# 07- Administrata




- ZYRE PERMANENTE
- ZYRE PERKOHSHME
- ZYRE TAKIMEVE
- KUZHINA
- FJETJA

maden group




- REGJIA PERMANENTE
- REGJIA PERKOHESHME
- ZYRE PERMANENTE
- ZYRE PERKOHSHME
- ZYRE TAKIMEVE
- SANITARI

08- Administrata

maden group





maden group

10- Salla operative



maden group




11 - Diagrami

madengroup


Fasade me sunduiq panel
dhe profile pasqyre
Profile pasqyre
Fasade me sunduiq panel
dhe profile pasqyre

12- Diagrami




13- Diagrami


Fasade me sanduiq panel
Sanduiq panel
Fasade me sanduiq panel
14- Diagrami
maden group


15- Diagrami
Fasade me rrjete metalike
Rjete metalike
Rjeta metalike
Ndricimi ne anen e brendshme
maden group


ORGANIZIMI




16- Situacioni

maden group



16- Baza Katit I

maden group



17- Baza Katit II

maden group


IMAZHET




maden group


GLOB-TRANS
maden group


maden group


maden group


maden group


maden group


maden group


ROVER
99-AD
made